



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione
P-nr.05/2017
Prishtinë, më 12 dhjetor 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan : Frashër Krasniqi dhe Mytaher Haskuka.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari-Avokat i Popullit, Tafil Rrahmani-IAP, Suzana Gashi-IAP, Sami Kurteshi, Driton Selmanaj, deputetë, Teuta Prekazi-UN “Human Rights, Hajredin Skënderi-Ambasada e Zvicërës, Shprese Sejdiu-GPVV, Donika Osmani-Ekonomia Online, Ervin Ibrahim-UNKT, Albulena Nuha-KTV, Gramos Paqarada-KDI, Valdrin Hasani-praktikant, Fillesë Demaku, praktikante, Besmir Radoniqi, praktikant, Anita Avdyli-praktikante dhe Leutrim Latifi, praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Kryetarja, propozoi që pikat: Diskutim për Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, dhe Shqyrtimi i propozim-vendimit të Avokatit të Popullit, në lidhje me zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit, të shqyrtohen si pika 1 dhe pika 2 të rendit të ditës, gjë që u miratua nga anëtarët.

Rendi i ditës:

1. Diskutim për Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, (i ftuar Avokati i Popullit, z.Hilmi Jashari);
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Avokatit të Popullit, në lidhje me zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit, (i ftuar Avokati i Popullit z.Hilmi Jashari);
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
4. Njoftim në lidhje me shqyrtimin e peticioneve nga Grupi i Punës i Komisionit,
5. Të ndryshme.

1. Diskutim për Raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës;

Kryetarja, tha se për shqyrtimin e Raportit me rekomandime Rasti Nr. 265/2017 Ex officio të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, kemi ftuar për raportim në Komision z. Hilmi Jashari, Avokat i Popullit.

Hilmi Jashari, tha se më 7 prill të vitit 2017, ka hapur hetime Ex officio, në bazë të një shkrimi në gazetën ditore “Zëri”, i cili flet për tarifën e rrymës dhe për pagesat që gjoja prezantohen se bëhen nga qytetarët e pjesës tjetër të vendit. Mbi këtë bazë, më 28 prill 2017, ia kam dërguar një letër Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ZRRE, ku kam kërkuar shpjegime nëse këto pretendime janë të qëndrueshme dhe i kam shtruar disa pyetje për këtë Zyrë.

Me 18 maj 2017, kam pranuar përgjigjeje nga ZRRE-ja, në lidhje me informatat që kam kërkuar dhe jam njoftuar se humbjet e energjisë elektrike në veri, trajtohen në bazën e Ligjit për energjinë, përkatësisht mbi bazën e dispozitës e cila flet për humbjet komerciale.

Kjo me fjalë tjera, i bie vjedhje e energjisë elektrike, e që kostoja vjetore është afër 8 milion euro, dhe sipas ZRRE-së kjo shpjegohet me faktin se sikur mos të mbulohehin këto shpenzime KEDS-i, do të pësonte humbje të mëdha, dhe do të ishte mundësia e madhe për të bankrotuar si kompani dhe për këtë qëllim është nxjerr ky vendim.

Ndërkohë kemi kërkuar një takim me përfaqësuesit e ZRRE-së, në Zyrën e IAP-it, për t’iu përgjigjur edhe disa pyetjeve shtesë të cilat i kemi pasur në mënyrë që të sqarohet kjo situatë.

Më 22 maj 2017, kemi dërguar dy letra tjera, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, me po të njëjtën pyetje, nëse kanë qenë në dijeni për këto zhvillime dhe nëse ka pasur aprovim paraprak.

Po ashtu, një letër ia kem dërguar edhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht departamentit për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve, nga të cilët kemi pranuar përgjigjeje që kanë pranua vlerësimin që është bërë nga ana e IAP-it.

Analiza juridike që është bërë është mbështetur në 4 ligje bazë. Vlerësimin që është dhënë nga ZRRE-ja, e kemi konsideruar si të papërshtatshëm sepse përkufizimet e ligjit flasin për humbjet komerciale përkatësisht vjedhjen e energjisë elektrike që për momentin nuk ka pas as

përshtatshmëri dhe as nuk ka qenë adekuate, ka qenë vlerësim i gabuar dhe e kemi konsideruar se ka qenë në kundërshtim të plotë me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

ZRRE-ja mohon zbatimin e rekomandimeve që i janë vu si barrë, kjo pastaj ka ndikuar që IAP-i, në pamundësi për të gjet zgjidhje tjetër juridike, kemi qenë të detyruar të sfidojmë ligjshmërinë e këtij akti dhe kemi kërkuar nga Gjykata për Konflikt Administrativ, përkatësisht Gjykata Themelore në Prishtinë, ta shfuqizojë si vendim të paligjshëm dhe të njëjtën kohë kësaj padie ia kemi përcjellë edhe një propozim për masë të përkohshme, duke i kërkuar gjykatës që deri sa të merret vendimi përfundimtar i saj, ta shfuqizojë këtë vendim nga zbatimi dhe të mos krijojë dëme të panevojshme për qytetarët e vendit.

Gjykata ka aprovuar këtë masë të zbatueshme me të cilën ka suspenduar ekzekutimin e Vendimit të ZRRE-së.

Këtë masë të gjykatës tani e kontestojnë ZRRE-ja dhe KEDS-i.

Miljana Nikoliq, tha se në vitin 2009 nuk ka pasur energji elektrike në veri të Kosovës, flas për katër komunat e veriut. Në atë kohë, ndërprerja e energjisë ka zgjatur më shumë se 20 orë dhe për të mos pasur katastrofë humanitare, atëherë Qeveria e Serbisë e ka nxjerr vendimin që ta furnizojë veriun me energji elektrike, dhe unë si qytetare e kam faturën nga Elektro Kosova.

Në vitin 2013, me Marrëveshjen e Brukselit, është dashur të regjistrohen dy kompani, e para është Elektrodistribucioni i Serbisë dhe e dyta Elektro-veriu.

Këto kompani disa herë kanë arritur që të aplikojnë për regjistrim dhe të marrin licencën, dhe katër herë kërkesat e tyre janë refuzuar.

Unë dua të parashtoj pyetjen, pse këto kompani të cilat është dashur të regjistrohen, nuk janë marrë parasysh në veri të Kosovës.

Më pas, ajo pyeti se a është menduar se në faturat të cilat i marrin qytetarët duhet të ekzistojë një klauzolë, ku shkruan, që një pjesë e çmimit paguhet për veriun e Kosovës.

Nëse kjo nuk shkruan në fatura, KEDS-i është dashur ta shkruaj këtë dhe gjithashtu unë vëreja në raportin e juaj se ju keni pasur vërejtje që KEDS-i, Rregullatorit për Energji nuk ja ka

paraqitur raportin financiar, dhe do të doja të marre përgjigjeje lidhur me këto vërejtje, apo në këtë pyetje të cilën unë e bëra.

Hilmi Jashari, në hetimin e rastit dhe raportin që i kemi njoftuar autoritetet e Kosovës dhe KEDS-in, kemi konfirmuar se rryma elektrike e shpenzuar në veri, inkasohet nga qytetarët e pjesës tjetër të vendit dhe vlera është 8 milion euro. Kjo është konfirmim zyrtar i dhënë nga ZRRE-ja, dhe kjo është bërë sipas tyre, me arsyetimin se sikur mos të ishte një vendim i tillë, kompania do të falimentonte.

Kur kemi shtruar çështjen se pse në faturë nuk është regjistruar niveli i inkasimit që bëhet, na është thënë se në vendimin e ZRRE-së është vendos që kjo shumë që ka vlerën 4.5% të faturës, ka hy në nivelin e çmimit të energjisë elektrike dhe për këtë arsye asnjë prej qytetarëve nuk ka vërejtur në faturën e vet që është duke paguar një çmim i cili realisht shpenzohet diku tjetër përkatësisht në pjesën veriore të vendit.

Miljana Nikoliq, pyeti në lidhje me mos licencimin e kompanive në veri të Kosovës, sipas Marrëveshjes së Brukselit.

Hilimi Jashari, theksoi se nuk jemi marrë me marrëveshjen e Brukselit, sepse nuk ka qenë ndonjë shqetësim për neve, sa i përket shkeljeve eventuale të të drejtave të njeriut dhe nuk ka pasur asnjë pretendim ankimor. Neve na intereson të dimë nëse ky vendim i ZRRE-së i vitit 2012, është i ligjshëm apo jo dhe cilat kanë qenë mundësitë e qytetarëve të vendit për ta kontestuar një vendim të tillë të padrejtë.

Madje, qytetarët nuk kanë qenë në dijeni dhe as nuk kanë mundur ta kontestojnë një faturë të tillë, për të cilën nuk është ditur se si është faturuar.

Sami Kurteshi, tha se ka lexuar raportin dhe ka disa pyetje specifike, është përmendur në raport termi - humbjet politike dhe është mirë të sqarohet çka do të thotë kjo, keni kërkuar bilancin e KEDS-it, me legjislacionin tonë a ka të drejtë KEDS-i, përmes ndihmës së shtetit dhe ZRRE-së, ta ngarkojë qytetarin, por, kur është në pyetje të dihet fitimi i kompanisë, nuk ka të drejt askush ta detyrojë KEDS-in, të tregojë për këtë raport financiar.

Në këtë rast ka vepër penale nga ZRRE-ja, dhe nga Institucionet shtetërore që kanë lejuar, sepse nga leximi i raportit del se ata e kanë ditur çka është duke u bërë.. A është konstatuar se ata me vetëdije kanë bërë cenimin e pronës së qytetarëve në të gjithë Kosovën.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se kjo çështje do të ishte mire të ngritej nga ish- Avokati i Popullit, sepse kemi pasur peticionin e qytetarëve për ngritjen e faturave të energjisë elektrike dhe e kemi shqyrtuar në Komision, ku kemi miratuar rekomandime në Kuvend, dhe kemi kërkuar nga ZRRE-ja, që të raportojë edhe në Kuvend dhe kam kërkuar të përgjigjen se a ka shkelje të ligjit. Atëherë, më është thënë se nëse ka shkelje të ligjit, të merren gjykatat me këtë, dhe tani konstatimet e IAP-it, në raport janë se ka pasur shkelje të ligjit.

Përveç rekomandimeve të IAP-it, ne si Komision të dalim me ndonjë rekomandim tjetër dhe ta diskutojmë si pikë të veçantë të rendit të ditës në seancë plenare.

Nëse është thënë që ZRRE-ja duhet të kërkojë buxhet nga Qeveria, kjo nuk është zgjidhje sepse po bëhet nga të njëjta shpenzime që po inkasohen nga qytetarët.

Teuta Haxhiu, tha se kam thirrur seancë për shkak të moszbatimit të rekomandimeve të IAP-it, është shqetësim moszbatimi i rekomandimeve nga Institucionet përgjegjëse, në këtë raport është shfaqur ajo se si u është bërë një plaçkitje e fshehur qytetarëve të vendit.

ZRRE-ja shumë herë ka marrë vendime në dëm të qytetarëve dhe është një pikëpyetje shumë e madhe për mua se në interes të kujt punon ZRRE-ja, por këtë problem ju si Avokat i Popullit, e keni ndriçuar.

Raporti i IAP-it nuk duhet shihet në Kuvend si raportet e Institucioneve tjera të pavarura, për mua është shqetësuese të votohet për apo kundër raportit IAP-it.

Ajo theksoi se mbështetja e jonë nuk do të mungojë për këtë Institucion, kemi nxjerr në Kuvend edhe një Rezolutë por as rezolutat nuk e obligojnë Qeverinë për ti zbatuar.

Mirjeta Kalludra, tha se në lidhje me këtë raport kemi biseduar edhe në një mbledhje paraprake, çështja që po trajtojmë është shqetësim duke pasur parasysh edhe gjendjen ekonomike të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe dalja në pah përmes këtij raporti se qytetarët po paguajnë rrymë për energjinë e shpenzuar në katër komunat veriore të Kosovës është shumë shqetësuese për qytetarët.

Kërkesë e qytetarëve tani është si do të bëhet kompensimi, cilat masa ligjore duhet ndjekur, dhe çfarë masa duhet të marrim ne si deputetë.

Kam parashtruar pyetjeje se mos ndodh e njëjta gjë edhe me faturimin e furnizimin me ujë, dhe kam marrë një përgjigjeje nga Avokati i Popullit, por do të ishte mirë edhe sot të kemi përgjigje.

Lirije Kajtazi, theksoi se kjo çështje është ngritur me të drejt nga IAP-i, me siguri se me këtë janë cenuar edhe konventa ndërkombëtare e jo vetëm ligjet tona.

Për mua po mbetet kjo çështje si jo e plotë, pa prezencën e ZRRE-së, dhe propozoj t'i kemi drejtuesit e bordit të ZRRE-së në Komision, dhe më pas ky raport të përcillet për Kuvend.

ZRRE-ja, duhet të sqarohet në Komision se kjo çështje, a është si rezultat i ndonjë marrëveshjeje politike dhe të shpjegohet pse janë shkelur të drejtat e qytetarëve, dhe se kjo mënyrë e faturimit patjetër se duhet të ndërpritet.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se e përgëzon Avokatin e Popullit për raportin dhe paraqitjen në mënyrë konstruktive të problemit. Ky shqetësim ka prekur çdo familje, nuk është që nuk e kemi vërejtur se faturat e rrymës janë shumë të fryra por, nuk e kemi ditur ku qëndron problem, deri sa ky problem është iniciuar nga Avokati i Popullit.

Ajo theksoi se 8 milion euro të paguhen nga shteti i Kosovës për militantë të cilët kanë vrarë, dëbuar njerëz nga shtëpitë e tyre, kjo është dy herë shkelje e të drejtave të njeriut.

Kërkoj sa më shpejt të gjendet një formë që të ju kompensohen këto shpenzime që i kanë paguar qytetarët e Kosovës dhe të kërkohet llogari edhe nga ZRRE-ja e edhe nga KEDS-i.

Saranda Bogujevci, tha se është shumë shqetësues fakti që është marr një vendim në nivel qendror pa u pyetur qytetarët për barrën që ua kanë hedhur.

Po flitet për kompensim, por kush do ta merr përgjegjësin për këtë vendim që është marrë pa dijeninë e qytetarëve dhe pa i informuar fare.

Albulena Balaj-Halimaj, problemi i faturave të energjisë elektrike, të lenë përshtypje se ekziston një marrëveshje e fshehtë diku.

Ajo pyeti se a ka mundësi të dihet ekzistimi i kësaj marrëveshjeje, pasi që askush nga ne deputetët, e aq më pak qytetarët nuk kanë qenë të njoftuar për këtë, pastaj ata që kanë bërë këtë duhet dhënë përgjegjësi, kushdo qofshin ata.

Gjëja më e paktë që duhet të bëhet për qytetarët është kompensimi i humbjeve që u janë shkaktuar.

Hilmi Jashari, shprehja humbje politike është përdorur në përgjigjen që kemi pranuar nga ZRRE-ja, dhe në analizën që kemi bërë dhe raportin që kemi bërë rezulton se një koncept i tillë si institut juridik nuk ekziston dhe si i tillë është i paqëndrueshëm.

Sa i përket bilancit të KEDS-it, ai theksoi se si është e mundur të merret një vendim për mbulimin e humbjeve, kur nuk dihet cilat janë humbjet dhe sa janë ato.

Në raportin vjetor të KEDS-it, që ka qenë i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financave, nuk del se ka humbje, siç pretendohet në shkresën e ZRRE-së në këtë rast.

Sa i përket pyetjes se a ka hetime penale, rasti tani është në proces të hetimeve dhe është duke u trajtuar.

Ngarkesa prej 4.5% e faturave të energjisë elektrike që është paguar për veriun, ka hyrë në nivelin e çmimit dhe unë supozoj se kjo është bërë për të mos u vërejtur nga qytetarët, sepse në

momentin kur do të kuptonin qytetarët këtë gjë, atëherë ata do ta shfrytëzonin mekanizmin e ankesës.

Sa i përket çështjes së kompensimit, tashmë është e ditur se kemi një vendim të një autoriteti gjyqësorë lidhur me këtë çështje dhe kemi konsideruar që për arsye të lehtësimit të qytetarëve që ata mos të ngarkohen tani me procedura, kjo çështje tanimë është detyrë e autoriteteve shtetërore që ta lirojnë qytetarin prej kësaj barre të procedimeve eventualisht gjyqësore.

Forma më e lehtë që ne kemi propozuar ka qenë kompensimi në formën e reduktimit të nivelit që është paguar në faturat e kaluara, të bëhet në faturat vijuese në vlerën e njëjtë.

Ky është minimumi që do duhet të ndodhte, ndërsa pjesa tjetër për shkak të dëmit që i ka bërë qytetarit me këtë proces kjo kompani, atëherë këta do të duhet të paguajnë një kompensim i cili do duhej përcaktuar si mostër nga gjykata mbi bazën e një ekspertize të saktë dhe pastaj ajo ti jepet qytetarit si shpërblim për dëmin që ju ka bërë, që është formë e kompensimit moral.

Nëse ka tendencë për tu mbuluar këto shpenzime nga Qeveria, nuk do duhet të ndodhte kjo, por, kemi bazën e subvencioneve për veriun ose bazën e kontributeve të Qeverisë dhe këto mjete mund të inkasohen nga Fondi për zhvillimin e veriut. Sa i përket dëmeve morale kjo do duhej të jetë një pjesë e veçantë që do duhej të paguhej nga vetë kjo kompani e cila do duhej të bëhej mbi bazën e një ekspertize gjyqësore.

Në lidhje me ekzistimin ose jo të një marrëveshjeje të fshehtë, tha se nuk është në dijeni.

Ne e kemi filluar rastin në gjykatë, tani po shpresojmë që të jetë në proces të shqyrtimit, sa po të filloj ky proces do të kërkojmë këtë që të bëhet një ekspertizë e dëmeve, eventualisht edhe e pjesës morale që u është bërë qytetarëve si pasojë e këtij vendimi, në mënyrë që të ketë një kompensim edhe një leksion për autoritet shtetërore, sepse nuk janë të kursyer nga mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Të gjithë duhet të paguajnë njëjtë kur shkelen të drejtat e njeriut, sikur çdo individ ose çdo autoritet tjetër apo person juridik.

Sa i përket Raporteve të Institucionit të Avokatit të Populli, do të ishte mirë të debatohet në Kuvend sepse i shërben për reflektim Kuvendit, por gjithmonë me kushtin e vetëm që ndikohet të Qeveria për të riparuar pasojat e shkeljeve të drejtave të njeriut dhe për ta vendos të drejtën që është shkelur.

Sami Kurteshi-tha se ky Komision ka obligim të kërkojë kontratën e lidhur mes KEDS-it dhe Qeverisë së Kosovës dhe të shihet se në kontratë mos ekziston ndonjë klauzolë që obligon ZRRE-në, apo ndonjë Institucion tjetër të ndërmer veprime të tilla.

Kryetarja, hodhi në votim propozimin që në mbledhjen e radhës, për të njëjtën pikë të rendit të ditës të ftohen për të referuar në Komisionin Funkcional, kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të ZRRE-së, gjë që u pranua e më pas ajo hodhi në votim propozimin që çështja e Raportit me rekomandime Rasti Nr. 265/2017 Ex officio të Avokatit të Popullit, në lidhje me faturimin e energjie elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, të shqyrtohet në seancë plenare si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Me 8 vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, propozimi u miratua .

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Avokatit të Popullit në lidhje me zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit

Kryetarja, tha se kemi Propozim-vendimin e proceduar nga ana e Avokatit të Popullit për zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Kemi marrë edhe një sqarim për procedim nga administrata e komisionit dhe arsyetimin lidhur me këtë çështje.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se edhe në legjislaturën 5, ka qenë shqetësim neni 8 paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, dhe se arsyetim për secilin kandidatë të propozuar nuk kemi dhe po ashtu nuk kemi as poentim për kandidatët, dhe renditja e kandidatëve obligim i kujt ka qenë.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se propozimi dhe renditja, siç është bërë, na len mundësi të zgjidhjes më të mirë, por si komision është mirë ti kemi CV-të e kandidatëve.

Mirjeta Kalludra, tha se nga Kuvendi i Kosovës ka kërkuar njëherë plotësimin e listës edhe me një kandidatë serb, meqenëse e ka dërguar vetëm një, por kur e ka plotësuar listën a ka shpallur për këtë konkurs.

Saranda Bogujevci, tha se në bazë të kësaj që është e pasqyruar këtu shihet se e gjithë procedura ka shkuar përmes konkursit.

Tha se është mirë kur të kemi pika sikur kjo që kërkon votim, është mirë të kemi më shumë sqarime dhe t'i kemi materialet e kompletuara edhe me CV-të.

Mbledhjen nga ky moment e kryesoi Lirie Kajtazi, nënkryetare e parë Komisionit.

Në fund të diskutimeve për këtë pikë, kryesuesja Lirije Kajtazi, hodhi në votim raportin me rekomandime për procedim në seancë plenare, sipas Propozim vendimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit, i cili u miratua njëzëri.

Kryetarja konstatoi se Komisioni Funkcional, i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, këto:

REKOMANDIME

I. I rekomandohet Kuvendit, që me votim të fshehtë, të zgjedhë 5 (pesë) zëvendësit e Avokatit të Popullit, nga lista e propozuar nga Avokati i Popullit, si në vijim:

II. Për 1 (një) pozitë të zëvendësit të Avokatit të Popullit nga radhët e gjinisë femërore, propozohen:

1. Majlindë Sinani-Lulaj,

2. Afërdita Rexha.

III. Për 1 (një) pozitë të zëvendësit të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve joshumicë, propozohen:

1. Aleksandra Dimitrijeviç,
2. Marija Raduloviç.

IV. Për 3 (tri) pozita të zëvendësve të Avokatit të Popullit, propozohen:

1. Albert Avdiu,
2. Murlan Prizreni,
3. Mehdi Geci,
4. Basri Berisha,
5. Baki Svirca,
6. Naile Alaj,
7. Edona Hajrullahu.

Në bazë të paragrafit 2 të nenit 8, të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit:

“Nëse asnjëri kandidatë nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, konsiderohet se asnjëri kandidatë nuk është zgjedhur për zëvendës të Avokatit të Popullit dhe Kuvendi mbyll procesin e votimit, përveç nëse ka më shumë se 2 (dy) kandidatë për një pozitë, përsëritet votimi”.

Nëse në raundin e parë të votimit, sipas pikës **IV**, nuk plotësohen tri pozitat, atëherë votimi përsëritet vetëm për këta kandidatë.

V. Arsyetimin e raportit në seancën plenare të Kuvendit, do ta paraqesë Duda Balje, kryetare e Komisionit.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;

Procesverbali i datës 8 nëntor 2017, u miratua pa vërejte.

Më pas, nënkryetarja hodhi në votim miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 15 nëntor 2017, ku Miljana Nikoliq, pati vërejtje tek fjala e saj në procesverbalin e datës 15 nëntor 2017, te pika numër 2, Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

Ajo theksoi se fjala e saj nuk është përkthyer siç ajo ka thënë.

Lirie Kajtazi, konstatoi se me këtë vërejtje miratohet procesverbali i datës 15 nëntor 2017.

4. Njoftim lidhur me shqyrtimin e peticioneve nga Grupi i Punës së Komisionit

Në fillim të kësaj pike të rendit të ditës, deputetja Saranda Bogujevci, kërkoi që të përfshihet në Grupin Punues për shqyrtimin e Peticioneve, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në mungesë të deputetit Frashër Krasniqi, i cili ishte anëtar i këtij grupi punues.

Kryesuesja, Lirije Kajtazi, konstatoi se me pëlqimin e anëtarëve të Komisionit, deputetja Saranda Bogujevci, do të jetë pjesë e Grupit Punues për shqyrtimin e Peticioneve, në vend të deputetit Frashër Krasniqi.

Mexhide Mjaku-Topalli, në lidhje me këtë pike të rendit të ditës, tha se grupi punues ka pasur takim dhe e ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fshatit Atmaxhë të komunës së Prizrenit lidhur me privatizimin e tokave bujqësore, dhe se në bazë të vendimit që ka nxjerr Qeveria e Kosovës, procesi i privatizimit të këtyre parcelave është pezulluar për një vit.

Albulena Balaj-Halimaj, për peticionin në fjalë tha se këtë vendim nuk është duke e respektuar Agjencia e Privatizimit të Kosovës, jo vetëm për këtë fshat por askund, është me rëndësi të ftohet AKP-ja, në Komision dhe të kërkojmë llogaridhënie pse nuk i zbaton vendimet e Qeverisë.

Saranda Bogujevci, tha se vendimi i Qeverisë bën fjalë për një vit, çka do të bëhet pas një viti, dhe mendoj që palët që janë të përfshira në këtë proces me qenë të pranishme këtu dhe të japin sqarime.

Lirije Kajtazi, në fund të kësaj pike konstatoi se Komisioni Funkcional, miratoi Njoftimin e Grupit të Punës për shqyrtimin e Peticioneve, si në vijim:

Grupi i Punës për shqyrtimin e Peticioneve, i Komisionit për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2017, shqyrtoi

peticionin e banorëve të fshatit Atmaxhë, të përfaqësuar nga z. Arbër Rexhaj, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me përfshirjen e pronave bujqësore të këtij lokaliteti në procesin e privatizimit.

Komisioni FunkSIONAL, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2017, miratoi propozimin e grupit punues të Komisionit dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, respekton Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 13/13, datë 10.11. 2017, ku kërkohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) që për periudhën 1 (njëvjeçare) të pezullojë procesin e privatizimit të pasurive të paluajtshme (tokave) që janë nën menaxhimin e saj.

5. Të ndryshme

Lirije Kajtazi, njoftoi rreth ftesës për drekë pune me Avokatin e Popullit, më 13.12.2017.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se kemi pasur në plan të ftohen Agjencia për Barazi Gjinore, dhe të raportojë dhe të ftohen disa zyrtarë nëpër komuna, dhe të shihet sa është duke u zbatuar objektiva e dytë perspektiva e grave në sektorin e sigurisë që është objektiv i Agjencisë. Nuk është organizuar as tryeza e as konferenca që kam propozuar dhe që kanë qenë me plan të punës.

Është mirë të vizitohet Shoqata e Grave Police të Kosovës dhe Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Ministrinë e FSK-së, të takohemi me to dhe të shikojmë çfarë brenga kanë dhe çka mund ti ndihmojmë ne si Komision.

Lirije Kajtazi, tha se këto vizita janë me interes dhe se duhet realizohen, por të kihet parasysh se jemi në fund vit, dhe se pothuajse agjendat janë parapa, kemi një mbledhje të komisionit, ditëve në vijim.

Lirije Kajtazi, tha se të njoftohet edhe kryetarja dhe të shikohet kur është mundësia për realizimin e takimeve me Shoqatën e Grave Police të Kosovës dhe me Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Ministrinë e FSK-së, ditëve në vijim dhe të bëhet njoftimi.

Ndërsa, u vendos që takimi i anëtarëve të Komisionit FunkSIONAL me përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore, të mbahet në muajin janar 2018.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje